


Ndihmë juridike për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara

Udhëzues për komunikimin gjatë
dhënies së ndihmës juridike për
fëmijët dhe personat me aftësi të
kufizuara dhe familjet e tyre



Kjo broshurë është përgatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi Ligjor i Komunitetit në Procesin e Deinstitutionalizimit" të cilin Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, me mbështetjen e UNICEF dhe Ambasadën britanike Shkup, filloi ta zbatojë në gusht 2019. Qëllimi kryesor i projektit është të sigurojë ndihmë dhe mbështetje për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në ushtrimin e të drejtave të tyre bazike njerëzore, nga njëra anë, si dhe mbështetje për personat që janë përgjegjës për ofrimin e drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas, nga ana tjetër.

Broshura është dedikuar për personat që punojnë në departamentet e ndihmës juridike falas në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Qëllimi i broshurës është t'u shërbejë administratorëve si udhëzues në komunikimin gjatë ofrimit të ndihmës juridike falas për fëmijët dhe familjet e tyre, duke u mundësuar ndihmë dhe mbrojtje efektive dhe në kohë.

—

Për çdo pyetje shtesë mund të drejtoheni në:
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
rr. "Naum Naumovski Borçe" nr.83, 1000 Shkup
+389 (0) 2 3119 073; +389 (0) 72 278 436
helkom@mhc.org.mk

Kjo broshurë është përgatitur në kuadër të projektit "Fuqizimi Ligjor i Komunitetit në Procesin e Deinstitutionalizimit" i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me mbështetjen e Ambasadës britanike Shkup dhe UNICEF. Mendimet dhe qendrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet dhe qendrimet e qeverisë britanike dhe UNICEF.

Ndihmë juridike për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara

Udhëzues për komunikimin gjatë
dhënies së ndihmës juridike për
fëmijët dhe personat me aftësi të
kufizuara dhe familjet e tyre

Autore: Biljana Sterjadovska-Stojčevska

Editore: Bojana Jovanovska

Përkthyes: Elizabeta Poljoska

09

Fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara

13

Karakteristikat dhe komunikimi me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara

15

Persona me shikim të dëmtuar

19

Persona me dëgjim të dëmtuar

22

Persona me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë

24

Persona me aftësi të kufizuara fizike

26

Persona me aftësi të kufizuara intelektuale

29

Persona me çrregullim të spektrit autik

32

Persona me kombinim të disa aftësive të kufizuara

35

Prindërit e fëmijëve dhe personat me aftësi të kufizuara

Fërmabajtja

Fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara

Çfarë do të thotë aftësia e kufizuar?

Aftësia e kufizuar nuk është diçka e pazakontë dhe është pjesë e diversitetit njerëzor. Vlerësohet se 15 përqind e popullsisë së botës ka një formë të aftësisë së kufizuar, një përqindje që pritet të rritet për shkak të kujdesit shëndetësor dhe ushqimit të dobët në fillim të jetës, numrit gjithnjë e më i madh i popullsisë së moshuar dhe konfliktet të dhunshme civile¹. Aftësia e kufizuar i prek jo vetëm individët, por edhe familjet e tyre të afërta dhe të rrethit më të gjërë, si dhe komunitetin në të cilin jetojnë njerëzit me aftësi të kufizuara, që do të thote shoqëritë në përgjithësi.

Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një grup heterogjen. Çështjet e statusit të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, përfshirja e tyre në komunitetin dhe shkalla e gëzimit të të drejtave të tyre bazike të njeriut mund të ndryshojnë dukshëm në varësi të llojit të aftësisë së kufizuar, mjedisit, kulturës, traditave, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik. Këto ndryshime dhe përvojat shumëdimensionale të personave me aftësi të kufizuara duhet të merren parasysh në përcaktimin e përfaqësimit, duke e përfshirë dhe përfaqësimin ligjor.

Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me shumë forma të diskriminimit që çojnë drejt përjashtimit të tyre nga më shumë sfera të jetës në shoqëri. Për shembull, qëndrimet ndaj fëmijët me aftësi të kufizuara, mungesa e një mjedisi gjithëpërfshirës mësimor, burimet e nevojshme njerëzore dhe burimet dhe materialet e përshtatura mësimore janë sfidat me të cilat përballen këta fëmijë në qasjen arsimore në shkollat e rregullta.² Prandaj, fëmijët me aftësi të kufizuara përfaqësohen në mënyrë joproporcionale mes moshatarëve që ndjekin klasa të rregullta. Gjithashtu, ndodh shpesh që fëmijët me aftësi të kufizuara të përballen me pengesa në qasjen e shërbimeve shëndetësore, përfshirë dhe shërbimet e rehabilitimit, si rezultat i paragjykimëve nga një pjesë e profesionistëve, në trajtimin joadekuat, si dhe

¹ Konceptualizimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe kontekstualizimi i tij në misionin e UNICEF, https://www.unicef.org/northmacedonia/media/3916/file/MK_ConceptualizingInclusiveEducation_Report_ENG.pdf

² www.unicef.org/disabilites/index_65316.html

infrastrukturës së paarrtshme dhe mungesës së pajisjeve adekuatë në dispozicion të institucioneve që i ofrojnë këto shërbime. Përveç kësaj, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara janë gjithashtu veçanërisht të prekshme dhe të diskriminuara shumëfish sepse ato janë në rrezik më të madh të dhunës me bazë gjinore, abuzimit seksual, neglizhencës dhe eksploatimit.

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në mënyrë normative bazohet në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe përmes saj realizohen përpjekjet për t'i analizuar pabarazitë që janë në thelbin e problemeve të zhvillimit dhe për t'i korrigjuar praktikat diskriminuese dhe shpërndarjen e padrejtë të fuqisë që e pengojnë përparimin e zhvillimit. Një nga dokumentet më të rëndësishëm që e garanton respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara është *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK)*³ dhe Protokollin Fakultativ i saj. Qëllimi i kësaj Konvente është promovimi, mbrojtja dhe sigurimi i gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe liritë themelore të personave me aftësi të kufizuara, si dhe promovimi i respektimit të dinjitetit të tyre. Sipas KDPAK, personat me aftësi të kufizuara janë *persona që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose shqisore, të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund ta pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri në nivel të barabartë me të tjerët*. Kjo qasje është në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në të cilin shkalla e funksionimit të një personi është konceptuar si një bashkëveprim dinamik mes shëndetit, faktorëve mjedisorë dhe faktorëve individualë të tij.

Kjo njihet gjithashtu si një *model shoqëror për aftësitë e kufizuara* që fillon të zbatohet në vend të modelit të mëparshëm mjekësor sipas cilit aftësia e kufizuar trajtohej si një problem shëndetësor ose gjendje mjekësore e personit, i cili mund të mjekohet ose shërohet nëpërmjet ndihmës mjekësore. Modeli shoqëror paraqitet si rezultat i një perceptimi më i madh i barrierave që e pengojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, sipas të cilit aftësia e kufizuar mund të zvogëlohet vetëm me përjashtimin e këtyre barrierave.

Me ndryshimin e paradigmës në drejtimin e modelit shoqëror, në dekadat e fundit është bërë e qartë se *diskriminimi i bazuar në aftësinë e kufizuar* do të thotë çdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë të aftësisë së kufizuar, me qëllim ose ndikim në shkeljen ose mohimin e njohjes, gëzimit ose realizimit të të gjitha të drejtave të njeriut,

³ *Miraturar më 13 dhjetor 2006 nga Kombet e Bashkuara, ratifikuar nga Republika e Maqedonisë së Veriut më 14 Dhjetor 2011*

në nivel të barabartë me të tjerët. Këtu përfshihen të gjitha format e diskriminimit, si dhe mohimi i **përshtatjes së arsyeshme** e cila përcaktohet si *modifikim dhe përshtatje e domosdoshme dhe adekuate, pa shkaktuar ngarkesë joproporcionale dhe të papërshtatshme, nëse është e domosdoshme në një rast konkret, për t'u siguruar personave me aftësi të kufizuara t'i gëzojnë dhe realizojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në nivel të barabartë me të tjerët.*⁴

Parimet themelore të KDPAK janë:

1. Respektimi i dinjitetit të qenësishëm, autonomisë individuale, përfshirë lirinë e zgjedhjes dhe pavarësinë e personave;
2. Mosdiskriminimi;
3. Pjesëmarrja dhe përfshirja e plotë dhe efektive në shoqëri;
4. Respektimi i dallimeve dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diversitetit njerëzor dhe njerëzimit;
5. Mundësi të barabarta;
6. Qasje;
7. Barazi mes burrave dhe grave;
8. Respektimi i aftësive zhvillimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara për ta ruajtur identitetin e tyre.

Klasifikimi i personave me aftësi të kufizuara

Sipas Rregullores për llojin dhe nivelin e aftësisë së kufizuar të personave me zhvillim mendor ose fizik⁵, persona me aftësi të kufizuara janë:

1. Personat me shikim të dëmtuar (me shikim të dobët dhe të verbërit);
2. Personat me dëgjim të dëmtuar (me dëgjim të dobët dhe të shurdhërit);
3. Personat me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë;
4. Personat me aftësi të kufizuara fizike;
5. Personat me aftësi të kufizuara intelektuale (të butë, të moderuar, të rëndë dhe shumë të rënda ose të thellë);
6. Personat me autizëm dhe njerëzit me çrregullim tjetër pervaziv të zhvillimit;
7. Persona me sëmundje kronikë, dhe
8. Personat me një kombinim të aftësive të kufizuara (njerëz me më shumë lloje të aftësive të kufizuara).

Kjo Rregullore, e cila në thelb e përmban modelin mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar, është ende në fuqi dhe e ka për qëllim përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe kufizimet që i ka një person. Gëzon fakti që aktualisht në vendin tonë ka filluar një proces vlerësimi i bazuar në funksionalitetin e këtyre individëve, që do të thotë vlerësim i nevojave dhe aftësive të tyre, në mënyrë që t'u mundësohet ta maksimizojnë potencialin për zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të tyre. Komisioni i Vlerësimit bazuar në Klasifikimin Ndërkombëtar të Funkcionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (ICF) filloi të funksionojë që para një vjet, duke aplikuar një model të ri të vlerësimit që përqendrohet në vlerësimin e asaj që një person mund të arrijë nëse punon mbi zhvillimin e potencialit të tij/saj. Zhvillimi i potencialit në kombinim me heqjen e kufizimeve/barrierave nga mjedisi, do të mundësojë pjesëmarrje aktive dhe të plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri.

Karakteristikat dhe komunikimi me fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara

Gjatë dekadave të fundit, në nivelin global janë bërë ndryshime të rëndësishme në drejtim të sigurimit të kushteve dhe mundësive më të mira për personat me aftësi të kufizuara për ta përmirësuar cilësinë e jetës së tyre (qasja në objekte dhe shërbime, rritja e qasjes në arsim, rritja e mundësive për punësim në tregun e hapur të punës dhe portretizimi real i personave me aftësi të kufizuara në media). Disa nga këto ndryshime në drejtim pozitiv vërehen edhe në vendin tonë në vitet e fundit. Fusha ku ende duhet të punojmë globalisht, dhe veçanërisht në vendin tonë, është fusha e komunikimit dhe ndërveprimit me personat me aftësi të kufizuara.

Këshilla të përgjithshme për komunikim me njerëzit me aftësi të kufizuara

- Kur njiheni me një person me aftësi të kufizuara, është e përshtatshme të përshendeteni me dorë. Njerëzit me funksion të kufizuar të dorës ose ata me gjymtyrë artificiale zakonisht mund të përshendeten me dorë. Përshendetja me dorën e majtë është gjithashtu një përshëndetje e pranueshme;
- Nëse ofroni ndihmë, pritni derisa të pranohet oferta. Pastaj dëgjoni ose kërkoni udhëzime nga ana e vetë personit me aftësi të kufizuara;
- Mos keni frikë të bëni pyetje kur nuk jeni të sigurt se si të veproni;
- Flisni në mënyrë të kuptueshme, me ritëm dhe shpejtësi normale, përdorni fjalim të qartë dhe konciz;
- Trajtohini të rriturit me aftësi të kufizuara si të rritur. Është ofenduese nëse u drejtoheni atyre me një ton zëri ose me një stil gjuhësor i cili u përshtatet fëmijëve të vegjël;

- Relaksohuni. Mos keni frikë të përdorni shprehje të zakonshme të tilla si “Shihemi më vonë” (nëse bisedoni me një person me shikim të dëmtuar) ose “A keni dëgjuar për këtë?” (Nëse komunikoni me një person me dëgjim të dëmtuar);
- Drejtojuni njerëzve me aftësi të kufizuara me emër vetëm kur keni arritur afërsi më të madhe;
- Bisedoni drejtpërdrejt me personin me aftësi të kufizuara në vend se me shoqëruesin e tij.



Personat me shikim të dëmtuar

Shikimi i dëmtuar nënkupton shikim i zvogëluar ose plotësisht i humbur. Mënyra e funksionimit të personave me shikim të dëmtuar përveç që varet nga shkalla e ruajtjes së shikimit, varet dhe nga koha se kur ka ndodhur dëmtimi, ose nga fakti nëse personat e kanë shikimin të dëmtuar që nga lindja apo kjo ka ndodhur më vonë.

Implikimet funksionale të dëmtimit të shikimit janë:

- Lohja e syve;
- Detyrat vizuale mund të shkaktojnë dhimbje koke;
- Akomodimi i ngadaltë ndaj kushteve të ndryshme të dritës;
- Fotofobia;
- Shikimi i ngjyrave si hije gri (akromatopsia);
- Vertigo (për shkak të nistagmusit - një gjendje e dridhjes së vazhdueshme të syve);
- Rritje e lëvizjes së kokës (karakteristike për personat me nistagmus);
- Pamundësi për të lëvizur në mënyrë të sigurt në hapësirë.

Mbështetje funksionale për personat me shikim të dëmtuar:

- Ulja e reflektimit;
- Rritja e shkronjave deri në një farë shkalle;
- Rritja e kontrastit;
- Përdorimi i xhamit zmadhues;
- Të merret parasysh ndriçimi (p.sh., personat me albinizëm okular duhet të kenë ndriçim difuzor nga prapa klientit, dritë normale deri në të zbehtë nga lart, drita e diellit të kontrollohet me perde ose grila veneciane);
- Të bëhen pushime të shpeshta gjatë leximit të një teksti më të gjatë;
- Të përdoret një shënues për të shkruar;
- Të përdoret një mbështetëse për të lexuar nga një kënd;
- Të mbahen syze të errëta;
- Të përdoren fletë transparente të verdha mbi tekstin për ta rritur kontrastin;
- Sfondi dhe veshja shumëngjyrëshe e bashkëbiseduesit mund të shkaktojnë vështirësi shtesë (p.sh. në rast të atrofisë së nervit optik).

Komunikimi me njerëzit me shikim të dëmtuar

- Kur flisni me një person me shikim të dëmtuar, jini ai që jeni dhe silluni natyrshëm;
- Tërhiqeni vëmendjen e personit duke iu drejtuar dhe/ose duke e prekur butësisht në dorë;
- Prezantoheni veten dhe tregoni se çfarë punoni - mos supozoni se personi do t'ju njohë nga zëri juaj;
- Flisni natyrshëm dhe qartë. Humbja e shikimit nuk do të thotë humbje e dëgjimit;
- Vazhdoni ta përdorni gjuhën e trupit. Kjo do të ndikojë në tonin e zërit tuaj dhe do t'i japë shumë informacion shtesë personit me shikim të dëmtuar;
- Mos harroni, nëse dikush është me shikim të dëmtuar, nuk do të thotë që nuk shikon fare;
- Përdoreni gjuhën e zakonshme. Mos i shmangni fjalët si “shikoni” ose bisedat për aktivitetet e përditshme, të tilla si shikimi i televizionit ose kinemasë. Një person me shikim të dëmtuar ndjehet këndshëm kur i thoni: “Sa bukur që të shoh!”;
- Emërtoheni personin kur njiheni për here të parë ose kur në një bisedë në grup i drejtoheni personit me shikim të dëmtuar;
- Asnjëherë mos e kanalizoni bisedën përmes një pale të tretë. Gjithmonë flisni drejtpërdrejt me personin në vend se me shoqëruesin e tij;
- Prezantohini njerëzit e tjerë të pranishëm në një bisedë në grup;
- Verbalizohini veprimet tuaja;
- Asnjëherë mos e lini bisedën, qoftë edhe në grup, pa njoftuar se po largoheni;
- Siguroni informacion në një mënyrë alternative/të disponueshme - audio, shkronja të mëdha ose me shkrimin “Braille”;
- Përdorni gjuhë të saktë dhe specifike kur jepni udhëzime. Për shembull, “dera është pesë hapa majtas” në vend të “dera është atje”;
- Kur përshkruani diçka, përfshini detaje të tilla si ngjyra, tekstura, forma dhe tipare të veçanta;
- Shmangini situatat ku ka zhurmë;
- Gjithmonë pyetni së pari nëse personi ka nevojë për ndihmë, dhe pastaj jepeni. Kur ofroni ndihmë, respektoheni dëshirat e

personit me shikim të dëmtuar. Mos insistoni të jepni ndihmë nëse personi e refuzon;

- Relaksohuni.

Ndonjëherë mund të gjendeni në një situatë kur ju duhet ta drejtoni personin me shikim të dëmtuar. Në atë rast:

- Lejoni që personi që po e drejtoni ta vendosë dorën e tij mbi shpatullën tuaj dhe t'ju ndjekë gjatë kohës që ecni;
- Vendoseni dorën drejtuese të personit që po e drejtoni mbi shpinën tuaj kur i afroheni një hapësire të ngushtë. Kështu, personi do të jetë në gjendje të qëndrojë prapa jush dhe të mund të lëvizë nëpër hapësirën e ngushtë;
- Lajmëroheni se po afroheni në skajin e trotuarit ose në fillim të shkallëve. Specifikoni se sa shkallë ka;
- Jepini kohë ta gjejë dorezën e derës, mbajtëset e shkallëve ose skajin e shkallëve;
- MOS e kapni pëllëmbën, dorën ose shpatullën e personit që po e drejtoni dhe mos e tërheqni me vete,
- MOS e rrëmbeni shkopin e bardhë ose rripin e qenit udhëzues për t'i thënë se ju do ta udhëheqni;
- MOS e përkëdhelni, ushqeni ose shpërqendroni qenin udhëzues. Ata nuk janë kafshë shtëpiake, ata janë mbështetës të personave me shikim të dëmtuar;
- Kur i ofroni sedilje, vendoseni butësisht dorën e personit në mbështetësen e sediljes ose në dorezën e sediljes në mënyrë që personi të mund ta kuptojë vendin e sediljes.



Persona me dëgjim të dëmtuar

Dëgjimi i dëmtuar nënkupton aftësi për dëgjim të zvogëluar ose plotësisht të humbur. Mënyra e funksionimit të personave me dëgjim të dëmtuar varet nga shkalla e dëmtimit të dëgjimit dhe shkalla e zhvillimit të të folurit gojor.

Komunikimi me personat me dëgjim të dëmtuar

- **Gjithmonë drejtoheni fytyrën drejt personit me dëgjim të dëmtuar.** Bëni kontakt me sy dhe mirëmbaheni atë gjatë kohës që flisni. Mundohuni mos ta mbuloni gojën tuaj, pasi shumë njerëz me dëgjim të dëmtuar mbështeten në leximin nga goja. Ju mund t'i drejtoheni personit duke e prekur butësisht shpatullën e tij.
- **Kontrolloheni zhurmën dhe ndriçimin.** Fikeni ose largohuni nga zhurma në sfond. Sigurohuni që fytyra juaj mos të jetë në hije dhe të mos bie dritë e fortë ose rreze të diellit në sytë e tyre.
- **Mbani distancë.** Qëndroni një ose dy metra larg personit me dëgjim të dëmtuar. Kjo është e rëndësishme për ata që kanë aparate dëgjimi, ata që lexojnë nga goja dhe që e përdorin gjuhën e shenjave.
- **Flisni qartë, ngadalë dhe në mënyrë stabile.** Mos murmurisni, bërtisni ose ekzagjeroni në lëvizjet e buzëve - kjo e vështirëson leximin nga goja. Mbahini duart, ushqimin dhe pijen më larg nga goja juaj gjatë kohës që flisni, dhe kurrë mos flisni gjatë kohës që përtpyni ushqim ose çamçakëz, ose pini duhan.
- **Përsëritni dhe parafrazoni nëse është e nevojshme.** Mundohuni ta thoni të njëjtën gjë në mënyrë tjetër. Kjo mund të ndihmojë.
- **Shkruajeni atë që e keni thënë.** Mos kini turp të shkruani ose të vizatoni për ta ndihmuar personin që të kuptojë. Nëse në momentin nuk keni letër dhe stilolaps në dorë, përdoreni telefonin për të shkruar në të.
- **Jepuni kohë** për ta përpunuar atë që e keni thënë dhe herë pas here kontrolloni nëse kanë kuptuar çdo gjë.
- **Jepuni mundësi për lloje të ndryshme të komunikimit.** Jo të gjithë personat me dëgjim të dëmtuar janë lexues të mirë të gojës, kështu që jini të hapur për lloje të ndryshme të komunikimit. Ju mund të komunikoni për herë të parë me një person me dëgjim të dëmtuar, por ata çdo ditë komunikojnë me njerëz që dëgjojnë. Mos u shqetësoni, ata do t'ju ndihmojnë.

Një nga gjërat më të rëndësishme për ta mbajtur mend është të vazhdoni të përpiqeni, edhe nëse personi me dëgjim të dëmtuar nuk e kupton atë që po e thoni disa herë. Njerëzit me dëgjim të dëmtuar shpesh tregojnë se kur dikush u thotë: “Ah, ti mos u shqetëso”, ose “Nuk ka rëndësi”, ndjehen sikur po u themi, “Ju nuk jeni i rëndësishëm për mua”. Edhe nëse keni nevojë ta parafrazoni ose shkruani katër ose pesë herë atë që dëshironi ta thoni, mos hiqni dorë. Jini të durueshëm. Për më tepër, mund të mësoni disa gjeste themelore për t'ju ndihmuar në komunikimin me njerëzit me dëgjim të dëmtuar. Po ashtu, në faqen e internetit të Bashkimit Kombëtar i të Shurdhërve

dhe Personave me Dëgjim të Dëmtuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut mund ta gjeni alfabetin e shenjave me një rrokje⁶ dhe me dy rrokje⁷.

Nëse keni nevojë për përkthyes të licencuar të gjuhës së shenjave në dispozicion në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund ta kontaktoni:

- Bashkimin Kombëtar i të Shurdhërve dhe Personave me Dëgjim të Dëmtuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut
<http://www.deafmkd.org.mk/lista-na-tolkuvaci/>
- Shoqatën "Gllasni race" (Duart e zëshme)
në numrin e telefonit +389 (0)76 488 360

⁶ <http://www.deafmkd.org.mk/ednoracna-azbuka/>

⁷ <http://www.deafmkd.org.mk/dvoracna-azbuka/>



Persona me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë

Një person me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë, është një person, e folura e cilit nuk korrespondon me moshën, ose është i pakuptueshëm, gramatikisht dhe sintaksisht i pa saktë, me shqetësime konvulsive në mekanizmin dhe automatizmin e të folurit, për shkak të cilës ekziston nevoja për terapist të folurit.

Komunikimi me personat me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë

Komunikimi me personat me pengesa në zë, të folur dhe gjuhë ndikohet nga lloji dhe shkalla e aftësisë së kufizuar. Për shembull, komunikimi me personat që kanë vështirësi të flasin pas një sulm në tru, dallohet nga komunikimi me njerëzit që nuk kanë zhvilluar aspak fjalim verbal. Por, ekzistojnë disa udhëzime të përgjithshme:

- Planifikoni më shumë kohë për të komunikuar me një person me pengesa në të folur;
- Nuk është problem të thoni “nuk kuptoj”. Nëse nuk kuptoni diçka, mos bëni sikur keni kuptuar. Kërkojini personit ta përsërisë atë që e ka thënë, pastaj përsëriteni atë që e keni kuptuar për të parë nëse është e vërtetë;
- Mos u përpiqni t'i mbaroni fjalitë në vend të tyre - lëri të flasin vetë;
- Mundohuni të bëni pyetje që kërkojnë përgjigje të shkurtra ose gjeste po/jo (me lëvizje të kokës);
- Nëse keni provuar disa herë të kuptoni, por pa sukses, pyetni nëse do të ishte më mirë të komunikoni në një mënyrë tjetër, për shembull, pyesni nëse mund të komunikoni duke shkruar ose vizatuar;
- Komunikimi i shkruar me njerëz me disleksi bëhet më së miri me një font të thjeshtë shkronjash, të zmadhuar dhe të shkruar në letër me ngjyrë të verdhë të zbehtë, me një ndarje më të madhe mes fjalëve dhe rreshtave;
- Përdorni fjali të qarta, të sakta dhe të thjeshta;
- Jepini mundësi për pushim nga leximi dhe kontrolloni nëse personi i ka kuptuar të gjitha fjalët.



Persona me aftësi të kufizuara fizike

Person me aftësi të kufizuara fizike është një person që ka zvogëlim ose humbje të aftësisë funksionale të një ose më shumë pjesëve të trupit (gjymtyrëve) me të cilën zvogëlohet ndjeshëm aftësia e personit për t'i përmbushur nevojat bazike të jetës.

Komunikimi me personat me aftësi të kufizuara fizike

- Nëse është e mundur, uluni pak dhe vendosuni në nivelin e syve të personit që përdor karrocë;
- Mos u mbështetni në karrocën ose në ndonjë pajisje tjetër që shërben për ta ndihmuar lëvizjen që personi e përdor. Mos e lëvizni karrocën ose automjetin e dikujt pa lejen e tij;
- Asnjëherë mos i trajtoni njerëzit që përdorin karroca në mënyrë të pahijshme duke i goditur në kokë ose në shpatull;
- Mos supozoni se personi dëshiron që ta shtyni karrocën e tyre. Së pari, pyetni nëse personi e dëshiron atë. Mos insistoni të jepni ndihmë dhe mos u ofendoni nëse personi ju refuzon;
- Kur u ofroni ndihmë, së pari pyetni se si konkretisht mund ta ndihmoni, ose ndiqini udhëzimet që do t'ju jepen. Mos e bëni atë që ju mendoni se është më e mira;
- Ofroni ndihmë nëse ju duket se personi ka vështirësi gjatë hapjes së derës;
- Nëse i telefononi një personi me aftësi të kufizuara fizike, lejoni që zilja të bie më gjatë se zakonisht, për t'i dhënë më shumë kohë për të arritur tek telefoni;
- Nëse duhet të shkoni diku së bashku, përshtateni ritmin tuaj të ecjes sipas shpejtësisë së tij/saj. Mos ecni shumë përpara;
- Diskutohini opsionet e transportit për aktivitetet dhe ngjarjet. Mendoni se çfarë do të jetë më e sigurt, më e pranueshme dhe më pak stresuese për individin dhe familjen e tij;
- Kontrolloni nëse vendet dhe hapësirat për aktivitete janë të aksesueshme (përfshirë dhe tualetet) dhe nëse ato kanë hapësirë të mjaftueshme për një person që përdor ndonjë pajisje ndihmëse për lëvizje;
- Kur organizoni takime me një person që përdor karrocë, siguroni hapësirë të mjaftueshme në tryezën, ose hiqni një karrige dhe sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme për të lëvizur lirshëm në hapësirën.



Persona me aftësi të kufizuara intelektuale

Sipas Rregullores për llojin dhe shkallën e aftësisë së kufizuar intelektuale ose fizike të personave, këta persona emërohen si persona me aftësi të kufizuara mendore, por është më e përshtatshme dhe më e pranueshme të përdoret termi persona me aftësi të kufizuara intelektuale. Këta persona janë me zhvillim mendor të ngadalsuar ose jo të plotë, i cili veçanërisht karakterizohet me dëmtim të aftësive që shfaqen gjatë periudhës së zhvillimit dhe që kontribuojnë për nivelin e përgjithshëm të inteligjencës, siç janë aftësitë njohëse, të folurit, motorikës dhe sociale. Tek disa persona me aftësi të kufizuara intelektuale paraqiten edhe çrregullime psikiatrike shoqëruese. Një pjesë e madhe të personave me aftësi të kufizuara intelektuale kanë vështirësi të kujdesen për veten e tyre dhe të arrijnë pavarësi të plotë në aktivitetet e tyre të përditshme.

Personat me aftësi të kufizuara intelektuale janë të ndarë në katër grupe:

- Persona me aftësi të kufizuara intelektuale të buta;
- Persona me aftësi të kufizuara intelektuale të moderuara;
- Persona me aftësi të kufizuara intelektuale të rënda;
- Persona me aftësi të kufizuara intelektuale shumë të rënda (të thella).

Komunikimi me personat me aftësi të kufizuara intelektuale

Në përgjithësi, personat me aftësi të kufizuara intelektuale kanë vështirësi në komunikimin. Ata kanë vështirësi t'i kuptojnë kërkesat dhe pyetjet dhe t'u përgjigjen në mënyrë adekuate. Kjo shpesh është arsye që njerëzit e tjerë t'i shmangen kontaktit me ta, gjë që i izolon ende më shumë personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Kjo gjithashtu rezulton në mosmarrjen e ndihmës dhe mbështetjes së duhur nga të tjerët kur kjo është e nevojshme.

Të gjithë personat me aftësi të kufizuara intelektuale kanë aftësi të ndryshme gjuhësore dhe mënyra të komunikimit në varësi të aftësive, mundësive dhe përvojave të tyre. Për ta lehtësuar komunikimin me njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe për t'u dhënë atyre mundësi që të shprehen, është veçanërisht e rëndësishme të veproni në këtë mënyrë:

- Siguroni kushte në të cilat personi do të ndjehet i sigurt dhe i rehatshëm, sidomos gjatë kontaktit të parë;
- Mos supozoni paraprakisht çfarë mund dhe çfarë nuk mund personi të bëjë;
- Inkurajoheni personin të flasë. Jepini kohë që vetë t'i mbarojë fjalitë, edhe nëse kjo kërkon shumë kohë dhe është e vështirë për ata që të shprehen. Mos i mbaroni fjalët dhe fjalitë në vend të tyre;
- Nëse nuk keni kuptuar se çfarë ka thënë personi, pyeteni përsëri duke e parafrazuar pyetjen;
- Kuptoheni dhe merreni seriozisht atë që po e thotë personi;
- Përdorni fjalë të thjeshta dhe fjali të shkurtra;
- Sigurohuni që personi e ka kuptuar atë që e keni thënë;
- Nëse keni mundësi, gjatë shpjegimit, përdorni gjithashtu edhe foto ose video;
- Flisni drejtpërdrejt me personin, jo me shoqëruesin e tij;

- Respektoheni moshën e personit. Pavarësisht aftësive të zvogëluara intelektuale, nëse flisni me një të rritur, mos iu drejtoni si një fëmiju;
- Keni parasysh se personat me aftësi të kufizuara intelektuale kanë vështirësi të përqendrohen për një kohë të gjatë. Prandaj, bëni pushime më të shpeshta;
- Keni parasysh që njerëzit me aftësi të kufizuara intelektuale lehtë shpërqendrohen, ndaj fikini të gjitha pajisjet që mund t'i shpërqendrojnë (p.sh., telefonin celular, radion) dhe kërkoni nga kolegët që të mos hyjnë në zyrë gjatë bisedës;
- Nëse keni mundësi, bisedoni në habitatin e tyre;
- Ndërtoheni gradualisht besimin. Potencioni qartë disa herë gjatë bisedës se informacioni nuk do të ndahet me njerëz të tjerë ose tregoheni personin me të cilin do ta ndani dhe pse (për shembull, “Unë nuk do t'i them prindit/përkujdesësit prindëror/kujdestarit/mësuesit, por do të duhet ta ndaj me një person të një organi/institucioni më të lartë”);
- Jini të durueshëm dhe sigurojini personit mbështetje të përshtatshme gjatë komunikimit.



Persona me çrregullim të spektrit autik

Karakteristikat e personave me çrregullim të spektrit autik (ÇSA) dallohen sipas intensitet, shkallës dhe përfaqësimit të karakteristikave të dukshme, kështu që ka dallime të mëdha nga një person me ÇSA deri në një person tjetër, si dhe ndryshime tek i njëjti person me ÇSA gjatë kalimit të kohës.

Këto janë karakteristikat më të zakonshme tek personat me ÇSA:

- Probleme në bashkëveprimin shoqëror me njerëzit e tjerë;
- Shkallë të ndryshme të aftësive intelektuale;
- Aktivitete ose lëvizje të përsëritura të trupit;
- Nevojë për rutinë;
- Hiper ose hiposensivitet të një ose më shumë shqisave;
- Interes i jashtëzakonshëm për objekte të caktuara;
- Probleme të mundshme neurologjike (p.sh., epilepsi shoqëruese);
- Karakteristika të ndryshme të sjelljes (shfaqja e mundshme e agresionit ndaj të tjerëve, vetë-agresivitet, destruktivitet, sulme mllefi, irritim, etj.).

Komunikimi me personat me ÇSA

- **Flisni qartë.** Kjo mund të duket si diçka që nënkuptohet, por nganjëherë njerëzit kanë vështirësi të flasin qartë dhe thjeshtë. Përpiquni që gjithçka që flisni të jetë brenda temës. Përpiquni të flisni qetë dhe qartë. Çfarë është më e rëndësishme, përpiquni t'i eliminoni format joverbale të komunikimit, siç janë gjestet e duarve dhe shprehjet e fytyrës. Evitoni fjalët që kanë kuptime të shumta.
- **Mos parashtroni shumë pyetje.** Sigurisht, ofrimi i shërbimeve për njerëzit me ÇSA kërkon që të bëni shumë pyetje, por përpiquni të bëni pyetje të shkurtra dhe specifike sa herë që të jetë e mundur. Pyetjet e hapura për njerëzit me ÇSA janë problematike. Nëse përdorni pyetje me përgjigje po ose jo, personi mund t'ju përgjigjet duke e përsëritur fjalën e fundit që e ka dëgjuar, pa e kuptuar pyetjen ose t'ju përgjigjet duke e përsëritur pyetjen. Përpiquni të bëni një seri pyetjesh me përgjigje po ose jo për ta përcaktuar përgjigjen, dhe më pas bëhuni pyetjet kryesore të cilave duhet t'iu përgjigjet me përgjigje po ose jo. Gjithashtu, rikonsideroni nëse pyetjet tuaja janë plotësisht të nevojshme. Dhe mos harroni të jepni shumë kohë dhe hapësirë për të marrë një përgjigje të plotë.
- **Jepuni mjaftueshëm kohë.** Një person me ÇSA mund të ketë nevojë për pushime të shpeshta. Shpjegojini qartë se ai/ajo do të ketë pushim për një kohë të caktuar dhe se çfarë do të ndodhë më pas. Shenjat që ata fillojnë të bëhen me ankth dhe kanë nevojë për pushim mund të përfshijnë: të folur të përsëritur, dridhje të duarve ose lëvizje të tjera të përsëritura,

vetë-dëmtim (p.sh., kafshim të duarve, bërtitje ose sjellje të tjera shqetësuese).

- **Jini kreativ.** Sarkazma, ironia dhe metaforat shpesh janë konfuze për njerëzit me ÇSA dhe ndodh shpesh që ata mos t'i kuptojnë ato. Ata kanë tendencë t'i kuptojnë gjërat fjalë për fjalë, kështu që përpiquni të flisni në mënyrë konkrete. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur jepni udhëzime.
- **Shqiptoheni emrin e tij/saj.** Mungesa e vëmendjes dhe hiperaktiviteti janë të zakonshme tek njerëzit me ÇSA. Një teknikë e thjeshtë që të siguroheni që gjithmonë e keni vëmendjen e personit me ÇSA është ta përdorni shpesh emrin e tyre (për shembull, thuheni gjithmonë emrin e tyre në fillim të një fjalie).
- **Tregojuni "nikoqir/e" i/e mirë.** Shumë njerëz me ÇSA tregojnë mënyra të jashtëzakonshme të komunikimit. Ky është një mekanizëm që ata e përdorin për t'u ndier më të rehatshëm dhe për t'i stimuluar shqisat. Mundohuni që mos të ndjeheni pakëndshëm ose të shqetësuar, thjesht pranojini të gjitha vetitë. Mbështetja vizuale (përdorimi i imazheve dhe simboleve gjatë komunikimit) mund të jetë shumë e dobishme.
- **Jini të vetëdijshëm dhe të ndjeshëm.** Mundohuni mos të bëni supozime për ndonjë person për shkak të mënyrës se si sillet ose për shkak se jeni të vetëdijshëm për kufizimin e aftësisë së tyre. Sigurisht, përshtateni stilin tuaj të komunikimit, por mos bisedoni ose mos bëni supozime negative për aftësitë e tyre intelektuale. Kjo mund të shkaktojë ofendim dhe pakënaqësi.

Gjithnjë të keni parasysh se nëse njihni një person me ÇSA, ju njihni vetëm një person me ÇSA. Janë shumë sjellje, karakteristika dhe gjendje neurologjike që e përbëjnë spektrin. Është e pamundur t'i njihni detajet e sakta të gjendjes së një personi me ÇSA, por ajo që është e rëndësishme është të jini sa më të përgatitur dhe të durueshëm në komunikimin.



Persona me një kombinim të aftësive të kufizuara

Bëhet fjalë për persona që kanë disa lloje të aftësive të kufizuara që kërkojnë shumë më shumë vëmendje dhe nevojë për mbështetje. Kombinimi i aftësive të kufizuara mund të nënkuptojë prani të njëkohshme të dy ose më shumë çrregullimeve, të tilla si çrregullim shqisor dhe motorik ose aftësi e kufizuar intelektuale me çrregullim shqisor dhe/ose dëmtim motorik shtesë. Shumë njerëz me aftësi të kufizuara intelektuale janë në të vërtetë njerëz me një kombinim të aftësive të kufizuara, për arsye se tek këta individë, nëse bëhet fjalë për një shkallë më të rëndë të dëmtimit intelektual, detyrimisht janë të pranishme edhe problemet e të folurit dhe madje edhe mungesa e plotë e të folurit.

Persona me një kombinim të aftësive të kufizuara janë gjithashtu edhe personat me dëmtim të dyfishtë shqisor, tek të cilët njëkohësisht janë të pranishme çrregullime të shumta shqisore, siç janë shikimi dhe dëgjimi i dëmtuar. Zhvillimi i një personi me një kombinim të aftësive të kufizuara ndikohet nga shkalla dhe lloji i dëmtimeve dhe nga koha kur kanë ndodhur ato (a bëhet fjalë për një gjendje kongjenitale apo më të vonshme). Sidoqoftë, disa persona me një kombinim të aftësive të kufizuara, veçanërisht ata me një dëmtim shqisor të dyfishtë, mund të jenë në gjendje të flasin ose të lexojnë. Por ka edhe raste kur komunikimi është jashtëzakonisht i kufizuar dhe reduktohet vetëm në shprehjen e nevojave bazike të personit me një kombinim të aftësive të kufizuara.

Komunikimi me njerëzit me dëmtim shqisor të dyfishtë

Jini të vetëdijshëm se ekzistojnë teknika të ndryshme që përdoren për të komunikuar nga ana e, dhe me njerëzit me dëmtim shqisor të dyfishtë. Çdo person është ndryshe. Për shkak se ka shumë ndryshueshmëri në shkallën e humbjes shqisore dhe për shkak se tejkalimi i këtyre kufizimeve është një sfidë e madhe, ekziston një ndryshueshmëri e madhe edhe në mënyrat se si këta persona komunikojnë, duke i përfshirë:

- Të folurit;
- Komunikimi me shkrim;
- Simbolet grafike dhe jo taktile;
- Simbolet dhe shenjat taktile të objekteve;
- Gjestet;
- Shprehjet e fytyrës ose tingujt që e tregojnë ndjenjën ose mendimin;
- Gjuha e shenjave;
- Gjuha e shenjave taktile;
- Shkrimi “Braille”;
- Shenjat e prekjes;
- Veprimi simbolik (për shembull, ju çon deri tek çezma për t'ju thënë se dëshiron ujë).

Përgatituni të përballeni me keqkuptime në komunikim.

Në raste të caktuara, mund të mos jetë e mundur që publiku i gjerë të komunikojë me njerëzit me dëmtim shqisor të dyfishtë. Nuk është rast i rrallë që profesionistët e komunikimit të kenë vështirësi në komunikim ose madje edhe të mos komunikojnë plotësisht efektivisht me bashkëbiseduesin e tyre me dëgjim dhe shikim të dëmtuar. Shpesh, njerëzit që nuk janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë të rregullt me njerëz me dëmtim shqisor të dyfishtë vendosin ta injorojnë komunikimin ose edhe vetë personin. Mos e bëni atë! Kërkoni ndihmë nga dikush tjetër që mund të kuptojë se çfarë po përpiqet të thotë personi ose provoni ndonjë metodë tjetër të komunikimit. Mos u dorëzoni.

Merrini duart e personit që është me dëmtim të dyfishtë shqisor.

Duart janë veshët, sytë dhe zëri i shumë njerëzve që e kanë këtë çrregullim.

- **Gjuha e shenjave dhe modifikimet.** Disa njerëz me dëmtim të dyfishtë shqisor e përdorin gjuhën e shenjave. Ndonjëherë një person me shikim të dobët mund t'i shikojë shenjat më mirë nëse personi vesh veshje që janë në kundërshtim me ngjyrën

e tij ose të saj të lëkurës (p.sh., një person me lëkurë të bardhë duhet të veshë një këmishë me ngjyrë të errët).

- **Shenja të përshtatura.** Disa njerëz me dëmtim shqisor të dyfishtë me shikim të kufizuar periferik mund të preferojnë që bashkëbiseduesi të bëjë gjeste në një hapësirë shumë të vogël, zakonisht në nivelin e gjoksit. Disa shenja të vendosura në nivelin e belit mund të kenë nevojë të përshtaten (për shembull, gjesti “rrip” duhet të tregohet në nivelin e gjoksit dhe jo në nivelin e belit).
- **Gjuha e shenjave taktile.** Personi me një dëmtim të dyfishtë shqisor i vendos duart mbi duart e bashkëbiseduesit për ta ndier formën, lëvizjen dhe vendndodhjen e shenjave. Ndoshta disa nga shenjat dhe shprehjet e fytyrës duhet të ndryshohen (për shembull, gjesti me kokë “nuk kuptoj” mund të zëvendësohen me tundje të dorës). Njerëzit me dëmtim të dyfishtë shqisor mund të përdorin një gjuhë taktile të shenjave me njërën ose të dy duart.
- **Shkrimi taktil me gisht.** Zakonisht, personat me dëmtim të shikimit të cilët më vonë e kanë humbur dëgjimin ose personat me dëmtim të dëgjimit të cilët e kanë zhvilluar zakonisht të lexuarit të gojës dhe më vonë e kanë humbur shikimin dhe nuk dine se si ta përdorin gjuhën e shenjave, preferojnë shkrim taktil me gisht. Personi me çrregullim të dyfishtë shqisor e vendos dorën e tij në dorën e bashkëbiseduesit dhe i kërkon që të shkruajë me gisht në pëllëmbën e tij. Në këtë rast, çdo letër ka një vend të caktuar në pëllëmbën.



Prindërit e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara

Profesionistët që do t'i kenë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara për klientë është e nevojshme që t'i njohin fazat⁸ në të cilat prindërit shpesh kalojnë kur ballafaqohen me faktin se fëmija i tyre ka paaftësi. Rëndësia e njohjes së këtyre fazave lind nga probabiliteti i lartë që personat që ofrojnë ndihmë juridike ose tjetër, ose mbështetje për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara, kurrë nuk kanë qenë në kontakt të ngushtë me një fëmijë/person me aftësi të kufizuara ose me të afërmit e tyre, gjë që mund ta vështirësojë komunikimin me ata. Prandaj, zyrtarët shpesh ballafaqohen me vështirësi për ta kuptuar gjendjen psikologjike në të cilën gjenden prindërit, gjë që nga njëra anë shkakton që prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara mos të ndiejnë se personi i kupton nevojat e tyre dhe dëshiron t'i ndihmojë ata, dhe nga ana tjetër zyrtarët të mendojnë se prindërit kanë kërkesa shumë të mëdhaja.

8 *The Child With a Disability: Parental Acceptance, Management and Coping*, Kandel and Merrick: *Children and Disability, TheScientificWorldJOURNAL* (2007) 7, 1799-1809; *Parental reaction to disability*, TammyHedderly, Gillian Baird and Helen McConachie, *Current Paediatrics* (2003) 13, 30-35; *REAGIMET E PARA TË PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA*, Natasha ÇIÇEVSKA-JOVANOVA, Olivera RASHIQ-CANEVSKA, *KOLEKSIONI VJETOR, FAKULTETI FILOZOFIK- SHKUP* (2015), 175-187.

Në të njëjtën kohë, duhet të jemi të vetëdijshëm që kalimi nëpër këto faza nuk është linear dhe nganjëherë prindërit rikthehen në ndonjë nga fazat. Për shembull, nëse në një moment të caktuar prindërit e kanë kaluar fazën e mllëfit, ndoshta në një moment tjetër të jetës ajo sërish do të rikthehet. Prandaj gjëja më e rëndësishme është që zyrtarët të tregojnë empati ndaj tyre dhe të japin hapësirë dhe kohë të mjaftueshme për të zhvilluar një marrëdhënie që do të bazohet në besim dhe respekt të ndërsjellë.

Kërkimi shkencor dhe letërsia profesionale, si dhe deklaratat e prindërve e tregojnë ekzistencën e disa fazave tek prindërit në pranimin e aftësisë së kufizuar të fëmijës së tyre. Ato kryesisht përkohshëm me fazat e pikëllimit/keqardhjes që u prezantuan për herë të parë si model nga psikiatërja suedeze-amerikane Elizabeth Kubler Ross.⁹ Sipas Kubler Ross, pranimi i aftësisë së kufizuar nga ana e prindit mund të ndahet në këto faza:

⁹ Kubler-Ross, E. (1969) *On Death and Dying*.

FAZA E PARË:

Mohimi

– „Fëmija im do ta kalojë këtë. Gjithçka do të jetë në rregull“

Në këtë fazë, prindërit shpesh e mohojnë ekzistencën e devijimit të zhvillimit/aftësisë së kufizuar të fëmijës së tyre. Refuzimi dhe mohimi i aftësisë së kufizuar nga ana e prindërit sjellin pasoja më të mëdha për fëmijën me aftësi të kufizuara sepse humbet një periudhë e konsiderueshme për stimulimin e zhvillimit të fëmijëve. Disa prindër kurrë nuk dalin nga kjo fazë dhe i vetmi që humb për shkak të kësaj është vetë fëmija. Për këtë fazë është tipike ajo që prindërit kanë kërkesa dhe pritshmëri shumë të larta nga fëmija, gjë që ndikon negativisht tek ajo/ai sepse me dështimin e mundshëm fëmija mund ta humbasë vetëbesimin dhe vetëvlerësimin e saj/tij.

FAZA E DYTË:

Mëri

– „Nëse mësuesit/mjekët do ta bënin atë që ua them, gjithçka do të ishte mirë“

Në këtë fazë, prindërit mund ta nxjerrin jashtë mërinë e tyre, në formë të mllëfit, ose të tërhiqen dhe të bëhen pasiv për shkak të një ndjenje të fortë faji. Disa prindër verbalisht e sulmojnë çdo person që mund të fajësohet për “fatkeqësinë” e tyre. Ata shpesh janë të zemëruar dhe madje i quajnë “fajtorë” profesionistët që u ofrojnë ndihmë dhe mbështetje (për shembull, e fajësojnë doktorin që i ka njoftuar për diagnozën ose i akuzojnë mësuesit që punojnë me fëmijën e tyre se nuk janë profesionistë mjaftueshëm të mirë).

FAZA E TRETË:

Negocimi

– „Nëse e lë punën time/ia përkushtoj jetën fëmijës tim/filloj terapi/ regjistrohem në shkollë juridike, gjithçka do të jetë mirë”

Faza e tretë karakterizohet me shpresën se prindërit mund ta ndryshojnë gjendjen e fëmijës së tyre. Në këtë fazë, prindërit zakonisht kërkojnë zgjidhje të reja, të ndryshme dhe nganjëherë alternative, nëpërmjet të cilave shpresojnë se do të “gjejnë shërim” për gjendjen e fëmijës së tyre. Ata ende nuk e pranojnë realisht aftësinë e kufizuar.

FAZA E KATËRT:

Depresioni

– „Pavarësisht se çfarë bëj, kurrë asgjë nuk do të jetë mire.”

Këtë fazë e karakterizon ndjesia e fajit. Prindërit e fajësojnë veten e tyre dhe mendojnë se ata e kanë shkaktuar aftësinë të kufizuar të fëmijës së tyre. Përveç ndjesisë së fajit, paraqitet dhe ndjesia e turpërimit dhe pafuqisë.¹⁰ Në fakt, në këtë fazë prindërit fillojnë ta pranojnë aftësinë e kufizuar të fëmijës së tyre, por pikërisht për këtë, të dytë ose njëri prej tyre është i dëshpëruar. Faza kalon kur individi e kupton se nuk është fajtor për situatën.¹¹

¹⁰ <http://www.ldonline.org/article/5937/>

¹¹ <https://core-docs.s3.amazonaws.com/uploads/c6079d13e502135389cbb10b5a5e2dc8/Initially%20Learning%20About%20Your%20Child%20Having%20Special%20Needs.pdf>

FAZA E PESTË:

Pranimi

— „Kjo është. Nganjëherë edhe mirë është.”

Në fazën e fundit, prindërit e pranojnë situatën dhe faktin që nuk është punë e lehtë të rrisësh një fëmijë me aftësi të kufizuara, por tani gjejnë dhe bukuri në të.¹² Ata e shohin fëmijën e tyre ashtu siç është. Ky qëndrim i prindërve kontribuon që maksimalisht të shfrytëzohet potenciali i fëmijës. Arritja e kësaj faze varet shumë nga mbështetja e rrethit. Prindërit shpesh tregojnë se përvojnë negative në shoqëri, institucionet e papërgatitur ose trajtimi i papërshtatshëm dhe joempatik i mjekëve, infermierëve, mësuesve, avokatëve, fqinjëve, madje dhe anëtarëve të familjes mund t'i rikthejnë në fazat e mërisë ose depresionit.

¹² <https://core-docs.s3.amazonaws.com/uploads/c6079d13e502135389cbb10b5a5e2dc8/Initially%20Learning%20About%20Your%20Child%20Having%20Special%20Needs.pdf>

Duke e respektuar KDPAK dhe duke siguruar që të gjithë fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, pa përjashtim, u mundësohen, respektohen dhe mbrohen të drejtat e tyre, ne e realizojmë të drejtën e një shoqërie gjithëpërfshirëse për të gjithë. Kjo nuk mund të arrihet nëse të gjithë ne nuk ndërmarrim veprime dhe nëse fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nuk e kanë të drejtën e fjalës gjatë procesit. Në të gjitha përpjekjet tona (të individëve dhe shoqërisë në tërësi) është e rëndësishme të konsiderohen fëmijët dhe njerëzit me aftësi të kufizuara jo vetëm si ushtruesë të të drejtave, por edhe si **bartës të të drejtave** dhe si partnerë të vërtetë që angazhohen për ndryshime. Vetëm duke e respektuar moton e bashkësisë së njerëzve me aftësi të kufizuara **Asgjë për ne, pa ne**, ne mund të kontribuojmë për një shoqëri me të vërtetë gjithëpërfshirëse për të gjithë.

